



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.59 dt.24.04.1998

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të radhës me dt.24.04.1998, mbështetur në Ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, shqyrtoi e diskutoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik “Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të automjeteve të P.A.M.”, mbështetur në V.K.M. Nr.395, dt.20.05.1996 “Për disa ndryshime” në V.K.M. Nr.186, dt.18.03.1996 “Për shpejtimin e likuidimit të ndërmarrjeve të privatizuara”.

**VENDOSI**

1. Të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të pjesës së automjeteve e rimorkiove që nuk u blenë nga punonjësit, kur ndërmarrja (PAM Tiranë) kaloi në privatizim sipas Autorizimit të A.K.P.Tiranë Nr.1711, dt.11.07.1994.
2. Të miratojë shitjen e automjeteve e rimorkiove si skrap për shkrirje në metalurgji, sipas proces verbale përkatëse të hartuara nga grupi i punës, në mbështetje të V.K.Ministrave Nr.170, dt.03.04.1993 dhe Nr.170, dt.12.03.1995.
3. Të miratojë mbylljen e aktivitetit të ndërmarrjes për një afat kohor deri në likuidimin e plotë financiar të saj.
4. Në ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Transportit në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë Tiranë dhe Parku Automobilistik i Mallrave Tiranë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**